

ANALIZË HULUMTUESE

POLITIKAT SOCIALE NË NIVEL LOKAL

- KOMUNA E PRIZRENIT
- KOMUNA E RAHOVECIT
- KOMUNA E DRAGASHIT

Qershor 2018

Photo nga: Sefer Aliqaj

ANALIZË HULUMTUESE

POLITIKAT SOCIALE NË NIVEL LOKAL

- KOMUNA E PRIZRENIT
- KOMUNA E RAHOVECIT
- KOMUNA E DRAGASHIT

Qershor 2018

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
METODOLOGJIA	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
KONTEKSTI INSTITUCIONAL	10
MINISTRIA E PUNËS DHE MIREQENIES SOCIALE (MPMS)	10
PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE NE OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE	11
POLITIKAT E KOMUNAVE NË NDARJEN E SUBVENCIONEVE	15
KOMUNA E PRIZRENIT	16
KOMUNA E RAHOVECIT	20
KOMUNA E DRAGASHIT	22
POLITIKAT E KOMUNAVE NE PROGRAMIN E BANIMIT SOCIAL	26
REKOMANDIMET	28
LISTA E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA	29

COPYRIGHT © 2018. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Përgaditur nga: Naim Cahanaj

Me asistencë hulumtuese nga: Gentian Kryeziu

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jodomosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.



○ HYRJJE


Politikat sociale janë një grup politikash publike që synojnë sigurimin e mbrojtjes dhe mirëqenies sociale si një kërkesë morale dhe politike, si një domosdoshmëri ekonomike duke siguruar më shumë kohezion social dhe mundësi. Koncepti i mirëqenies sociale i referohet gjerësisht asaj që nevojitet për t'iu siguruar njerëzve burime dhe mundësi për një jetë të kënaqshme dhe produktive (Midgley & Livermore, 2009).

Shembuj klasikë të politikave sociale janë aktivitetet e qeverive (nacionale dhe lokale) në sigurimin e financave dhe shërbimeve për qytetarët e tyre në fushat kryesore: mbrojtje sociale (e njohur si sigurimi social); shërbimet shëndetësore; shërbimet e arsimit; **sigurimi i strehimit dhe subvencioneve; shërbime sociale personale.**

Procesi i reformës dhe decentralizimit në Kosovë, nivelit lokal i ka dhënë autoritet dhe përgjegjësi të plotë në adresimin e politikave sociale si: ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse etj.

Efikasiteti dhe efektiviteti në ofrimin e shërbimeve publike sociale varet nga vendosja e mekanizmave operacionalë nga ana e organeve të vetëqeverisjes lokale. Arritja e objektivave të komunave nuk mund të realizohet pa procedurra dhe kritere të brendshme në çdo nismë të politikave publike.


Ky hulumtim përqendrohet në analizimin e politikave sociale, kritereve dhe procedurave të aplikuar nga komuna e Prizrenit, Rahovecit dhe Dragashit në kontekst të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga politikat sociale. Qëllimi i kësaj analize hulumtuese është që të ngris efikasitetin dhe transparencën e institucioneve lokale, në krijimin e praktikave dhe standardeve të mira gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të politikave sociale.



○ METODOLOGJIA

Metodologjia e hartimit të këtij hulumtimi është bazuar kryesisht në të dhënat kualitative dhe kuantitative. Gjatë procesit të analizës si të dhëna kualitative janë shfrytëzuar burime të ndryshme të karakterit rregullues të politikave sociale në nivel vendi dhe atë lokal. Po ashtu është realizuar intervista gjysmë e strukturuar me drejtorë të drejtorive komunale për punë dhe mirëqenie sociale në tri nga komunat e targetura në këtë hulumtim, me qëllim të nxjerrjes së të dhënave lidhur me planifikimin e politikave sociale nga ana e komunave gjegjëse.

Është përdorur edhe metoda e hulumtimit kuantitativ duke vlerësuar të dhëna të ndryshme si dhe nxjerrja e statistikave mbi planifikimet buxhetore të komunave rreth politikave publike në fushat sociale. Procesi i analizimit të politikave sociale është shoqëruar nga praktikat hulumtuese paraprake, e sidomos lidhur me vendosjen e kritereve në dhënien e subvencioneve dhe kritereve në politikat banimit social, krahasimet mes tyre si dhe pajtueshmëria me legjislacionin aktual.





Në kuadër të MPMS operon Departamenti për politika sociale dhe familjare ku në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimtarisë së këtij departamenti hynë:

- **propozimi, hartimi dhe sigurimi i zbatimit të dokumenteve/strategjive në fushën e politikave sociale dhe të familjes;**
- **propozimi, hartimi dhe monitorimi i zbatimit të standardeve për shërbimet sociale dhe familjare;**
- **trajtimi i kërkesave për licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare;**
- **menaxhimi me skemat e përfitimeve për familjet e varfra, fëmijët me aftësi të kufizuar 1-18 vjeç dhe me pagesa për strehim familjar;**
- **hartimin e analizave në fushën e politikave sociale dhe familjare;**
- **planifikimi dhe marrja pjesë në administrimin e projekteve të cilat financohen nga fondet e BE-së dhe organizatave tjera mbështetëse ³.**

PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE

Komunat ushtrojnë kompetenca vetanake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin ⁴. Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm, në **ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale**.⁵


Autoritetet qendrore në Republikën e Kosovës u delegojnë përgjegjësi komunave, në pajtim me ligjin, për kompetencat vijuese:

- shënimet kadastrale;
- regjistrimin civil;
- regjistrimin e votuesëve;
- regjistrimin e biznesit dhe licencimin;
- **distribuirimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve)**

³ Është faqja e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, <http://mpms.rks-gov.net/sq-al/departamentet/departamenti%20p%C3%ABrpolitikasocialedehefamiljes/fush%C3%ABveprimtaria.aspx>

⁴ Neni 16 i Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

⁵ Po aty neni 17



○ mbrotja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjëve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria⁶.

Secila komunë, përmes drejtoratit të saj përkatës, është përgjegjëse për sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit të saj sipas politikave të specifikuar nga Ministria. Komunat, ndonëse kanë përgjegjësinë e përgjithshme për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në territorin e tyre, asnjë anëtar i zgjedhur i asamblesë komunale ose zyrtar i komunës nuk mund të jep urdhëresa në lidhje me menaxhimin profesional të cilitdo rast të veçantë të shërbimeve sociale dhe familjare dhe as të ketë qasje në të dhënat konfidenciale të rastit.

Drejtoratet e komunave kryejnë shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre përmes aktiviteteve të qendrës për punë sociale ose duke siguruar financim apo ndonjë ndihmë tjetër materiale për organizatat joqeveritare që merren me këtë veprimtari.

Drejtoratet kanë kompetencë që të marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të tyre. Ato duhet të përgatisin plane vjetore për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve sociale dhe familjare si dhe mbajnë shënime e statistika siç specifikohet nga departamenti, duke qenë të detyruara që t'i paraqesin atij raportin për aktivitetet e tyre në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për çdo vit, si dhe në çdo interval tjetër kohor, sipas kërkesës së departamentit. Në mënyrë që të promovojnë

het përfshirja e komunitetit - transparenca dhe llogaridhënia, çdo drejtorat angazhohet që të publikojë planin dhe raportin e tij vjetor.

Gjatë përgatitjes së planeve të tyre vjetore drejtoratet janë të obliguara që të konsultohen gjerësisht me shfrytëzuesit e shërbimeve sociale dhe familjare, përfaqësuesit e tyre, organizatat joqeveritare dhe grupet e tjera relevante të komunitetit dhe grupet profesionale në territorin e tyre në lidhje me zhvillimin, planifikimin dhe kryerjen e shërbimeve sociale dhe familjare⁷.

Shërbimet e ndihmës sociale brenda qendrave për punë sociale, të caktuara për të administruar skemën e ndihmës sociale, menaxhohen nga udhëheqësi i shërbimit të ndihmës sociale, i cili zgjedhet nga komuna, në bashkëpunim me Ministrinë⁸. Udhëheqësi i skemës së ndihmës sociale për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi, i përgjigjet drejtorit, përkatësisht drejtorisë përkatëse të komunës dhe i raporton Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ministria në rast të konstatimit të shkeljeve të rënda të administrimit të skemës së ndihmës sociale, mund ta marrë në administrim të drejtëpërdrejtë skemën e ndihmës sociale në atë komunë, për një periudhë jo më gjatë se një (1) vit. Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e procedurave, përgatitjen e lëndës, verifikimin e gjendjes socio-ekonomike dhe përzgjedhjen apo refuzimin e familjes në skemën e ndihmës sociale është nëpunësi i skemës së ndihmës sociale (menaxheri i rastit), ndërsa përgjegjësinë për vendimmarrje e ka udhëheqësi i shërbimit të skemës së ndihmës sociale⁹.

⁶ Po aty neni 18

⁷ Neni 6 i Ligjit Nr.02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare

⁸ Neni 3 i ligjit 04/L-096 për plotësim ndryshimin e ligjit Nr.2003/15 për skemat e ndihmës sociale në Kosovë, [http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Primar/Ligji%20per%20N.P.%20e%20Ligjit%20per%20skemen%20sociale%20\(shqip\).pdf](http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Primar/Ligji%20per%20N.P.%20e%20Ligjit%20per%20skemen%20sociale%20(shqip).pdf)

⁹ Po aty neni 3 paragrafi 3, 4 dhe 5



- **POLITIKAT SOCIALE
NË NDARJEN E
SUBVENCIONEVE**

○ KOMUNA E PRIZRENIT

Planifikimi i buxhetit të komunës së Prizrenit në tri (3) vitet e fundit (shih grafikunin) për Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka shënuar rritje nga viti në vit. Në vitin 2016, buxheti i kësaj drejtorie ishte në shumën prej 1.114.443 Euro, derisa për vitin 2018 janë paraparë 1.316.615 Euro. Investimet kapitale poashtu kanë shënuar rritje ku nga 940.443 Euro të parapara për vitin 2016, në vitin 2018 kemi 1.086.000 Euro.

Ndarjet buxhetore të DPMS për vitin 2018 orientohen në këto politika: 300.000 Euro për investime kapitale në strehimin e qytetarëve, 400.000 Euro për ndërtimin e banesave për kategoritë e luftës dhe rasteve sociale, 200.000 Euro për mbulimin e shëpnzimeve të varrimit, 350.000 Euro për ndërtimin dhe funksionalizimin e shtëpisë së pleqve si dhe subvencionimin e rasteve të rënda, mbështetje financiare për OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale në shumën prej 120.000 euro.¹⁰

Kuvendi i Komunës së Prizrenit në mbledhjen e mbajtur të datës 23 prill 2013, ka miratuar Rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve. Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë funksionimin dhe veprimtarinë e administratës komunale, përkatësisht caktimin e kritereve rreth ndarjes së mjeteve nga buxheti i Komunës nga pozicioni i subvencioneve¹¹.

Në nenin 12 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve janë specifikuar kriteret për ndarjen e subvencioneve nga ana e DPMS. Kjo drejtori në kuadër të politikave të saj kishte paraparë ndarje të subvencioneve për:

- Dimërishte për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së;
- Verime për fëmijët e dëshmoreve dhe fëmijët bonjakë të komunës së Prizrenit;
- Përkrahja e OJQ-ve që merren me çështje sociale;
- Sipas kërkesave kryesisht për ndihma emergjente familjeve në varfëri të skajshme;
- Mbështetja financiare për varrimin e më të afërmëve;
- Ndihmë emergjente në ushqim dhe artikuj higjienikë;
- Mbështetja financiare pleqve pa përkujdesje familjare dhe nënave vetushqyese për sigurimin artikujve të domosdoshëm për jetë;
- Ndihmë emergjente në rast të strehimit të përkohshëm;
- Ndihmë financiare në sanimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe aksidentale (bora, vërshimet, rryma elektrike etj.).



Pra, komuna e Prizrenit në Rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve në kuadër të DPMS nuk ka përcaktuar qartë kriteret për qasje në subvencione dhe si e tillë, Rregullorja komunale për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prizrenit duhet të ndryshohet me qëllim të specifikimit të qartë në përmbushjen e kritereve nga palët e treta për t'iu qasur subvencioneve nga ana e DPMS-së.

10 Intervistë me Drejtorin e DPMS z.Fejzë Kabashi – Komuna e Prizrenit

11 Neni 1 i Rregullores për ndarjen e subvencioneve, Komuna e Prizrenit, <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2018/01/rregullore-subvencion-26-prill.pdf>



Kriteret përcaktuara në kuadër të Rregullores komunale për dhënie e subvencioneve ishin: **dëshmi me shkrim për gjendjen e rëndë ekonomike, gratë vetëushqyese, pensionistët e vetmuar si dhe personat me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta.**


Pra, komuna e Prizrenit në Rregulloren komunale për ndarjen e subvencioneve në kuadër të DPMS nuk ka përcaktuar qartë kriteret për qasje në subvencione dhe si e tillë, Rregullorja komunale për ndarjen e subvencioneve në komunën e Prizrenit duhet të ndryshohet me qëllim të specifikimit të qartë në përmbushjen e kriterëve nga palët e treta për t'iu qasur subvencioneve nga ana e DPMS-së.

DPMS në komunën e Prizrenit, që nga data 13.03.2018 deri me 23.03.2018 kishte hapur thirrjen për aplikim për financimin e OJQ-ve në projektet e fushave sociale. Në kuadër të kësaj thirrjeje, si kritere ishin përcaktuar: aplikuesi duhet të dëshmojë se ka implementuar projekte në të cilat kanë qenë të përfshira grupet sociale (personat me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta dhe grupet e tjera të marginalizuara, projekt-propozimi të jetë unik dhe jo i implementuar më parë, në kushte të barabarta, në kushte të barabarta përparësi i është dhënë projekteve që kanë për synim involvimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara apo nevoja të veçanta. Në asnjë prej kriterëve nuk specifikohet shuma e financimit të projekt-propozimeve si dhe periudha e implementimit të projekteve që mbështeten nga ana e DPMS-së në nivel komunal.

DPMS duhet të krijojë politika standarde në financimin e OJQ-ve në fushat e ofrimit të shërbimeve sociale në nivel lokal duke përfshirë formatin e projekt-propozimeve, kriteret e nevojshme, përbërjen e komisionit, shumën e buxhetit për financim, afatin kohor të realizimit të projekteve etj.



BUXHETI I DPMS I SHPREHUR NË VITE





○ KOMUNA E RAHOVECIT

Administrata komunale organizohet në drejtorate. Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoritë e tyre me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi¹²

Në kuptim të autorizimeve ligjore nga dispozitat e nenit 32 të LVL-së dhe organogramit komunal, organizimi i brendshëm si dhe numri i drejtorive, sektorëve komunalë bëhet në bazë të Rregullores komunale për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorive dhe organeve të tjera të administratës lokale të Komunës së Rahovecit¹³. Në kuadër të statutit të Komunës së Rahovecit është e paraparë të funksionojë Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale. Kuvendi i Komunës, në raste të nevojshme mund të themelojë edhe drejtori të tjera për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të Komunës.

Buxheti i Drejtorsë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale (DSHPS) në komunën e Rahovecit nga viti në vit ka shënuar trend të rritjes. Meqenëse janë të inkuorporuara edhe politikat shëndetësore në kuadër të kësaj drejtorie, është e pamundshme të bëhet një ndarje buxhetore vetëm për politikat e përkujdesit social.

Në vitin 2016, kjo drejtori kishte 1.378.926 Euro, duke vazhduar me trend të rritjes së planifikimit të buxhetit nga vitit në vit. Në vitin 2018 kjo drejtori ka të planifikuar buxhetin në shumën prej 1.746.697 Euro në total. Për shërbimet sociale janë paraparë 108.766 Euro nga këto 12.000 Euro mallra dhe shërbime si dhe 5.000 Euro subvencione dhe transfere¹⁴. Sa i përket investimeve kapitale, komuna e Rahovecit në vitin 2018 nuk ka paraparë asnjë projekt kapital në sferën e politikave sociale¹⁵.

Komuna e Rahovecit me datë 07.09.2017 kishte hapur thirrjen për aplikim në mbështetje financiare për OJQ-të dhe shoqatat që zhvillojnë aktivitete në fushën sociale dhe ofrojnë shërbime sociale dhe familjare¹⁶. Në kuadër të kësaj thirrjeje, nuk ka kritere të qarta dhe strikte dhe kohën e implementimit të projektit sa i përket dhënies së subvencioneve për organizatat të cilat ofrojnë shërbime sociale brenda territorit të komunës së Rahovecit.

¹² Neni 62 paragrafi 1 dhe 3 i Ligjit Nr.03/L-40 për vetëqeverisje lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

¹³ Neni 85 i Stutit të Komunës së Rahovecit, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2017/10/Statuti-i-Komunes-se-Rahovecit.pdf>


¹⁴ Tabela në faqen 40 të Ligjit Nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

¹⁵ Po aty tabela faqe 51

¹⁶ Publikimi i njoftimit për thirrje, <https://kk-arkiva.rks-gov.net/rahovec/getattachment/f3dd47a8-269a-4362-b335-8620a4c98142/Thirrje-per-aplikim.pdf.aspx>



BUXHETI I DSHMS I SHPREHUR NË VITE



○ KOMUNA E DRAGASHIT

Komuna e Dragashit në Statutin e saj ka përcaktuar edhe numrin e drejtorive në nivel të organizimit të administratës komunale. Komuna e Dragashit ka përcaktuar tetë (8) drejtori komunale dhe njëra nga to është edhe Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (DSHMS)¹⁷ etj.

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për:

- ofrimin e kujdesit shëndetësor në komunë, në pajtim me dispozitat ligjore;
- Inspektimin e qendrave private të përkujdesit primar shëndetësor;
- Vlerësimin e nevojave për shëndetësi primare;
- Vendosjen e objekteve lokale për kujdesin primar shëndetësor;
- Zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH-së;
- Koordinon dhe mbikqyrë punën e QKM-F, QMF dhe ambulancave;
- Operimin e qendrave për punë sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale;

- Zhvillimin e planit strehimor për territorin e komunës;

- Sigurimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare brenda territorit, sipas standardeve të përcaktuara nga MPMS¹⁸.

Për politikat speciale komuna e Dragashit nuk ka paraparë asnjë linjë buxhetore për investime kapitale dhe subvencione. Në projekt-buxhetin e vitit 2018, kjo komunë, vetëm në kategorinë e shërbimeve dhe mallrave ka paraparë 10.000 euro¹⁹.

Komuna e Dragashit duhet të rris buxhetin komunal në politikat sociale si në subvencione ashtu edhe në shpenzime kapitale.



Për politikat sociale komuna e Dragashit nuk ka paraparë asnjë linjë buxhetore për investime kapitale dhe subvencione. Në projekt-buxhetin e vitit 2018, kjo komunë, vetëm në kategorinë e shërbimeve dhe mallrave ka paraparë

10.000 euro

17 Neni 62 paragrafi 2 i Statutit të Komunës së Dragashit, <https://kk-arkiva.rks-gov.net/dragash/getattachment/Home/statuti-i-komunes-dragash.pdf.aspx>

18 Po aty neni 62

19 Tabela 4.1 e Ligjit Nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

**BUXHETI I DSHMS
I SHPREHUR NË VITE**



**● POLITIKAT E KOMUNAVE
NË PROGRAMET E
BANIMIT SOCIAL**

POLITIKAT E KOMUNAVE NË PROGRAMET E BANIMIT SOCIAL

Bazuar në legjislacionin aktual, komunat kanë hapësirë dhe mundësi të hartimit të politikave në programet e banimit social. Programet e veçanta të banimit bëhen përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- banesat e ndërtuara nga Komuna;
- qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- banesat e tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim²⁰.

Kriteret bazë për përcaktimin e radhës së përparsisë janë: *statusi i banimit, lartësia e të ardhurave, gjendja shëndetësore, invaliditeti dhe struktura e familjes*²¹. Kryetari i komunës me vendim përcakton përbërjen dhe kryesuesin e Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e familjeve të cilat konkurojnë për të përfituar nga programet e veçanta të banimit²².

Me kontratë të qiradhënies së banesës rregullohen kushtet nën të cilat qiradhënësi jep, ndërsa qiramarrësi pranon banesën për banim nën shumën e caktuar të qirasë²³. Qiramarrësi ka të drejtën e shfrytëzimit të lirë dhe të pa penguar të banesës. Qiramarrësi do ta shfrytëzojë banesën ekskluzivisht për qëllime të banimit²⁴. Përfituesve u ndahet banesa në shfrytëzim në afat të pacaktuar me vlerësim të gjendjes ekonomike çdo vit²⁵.

20 Neni 3 i Ligjit Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

21 Neni 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

22 Neni 5 i Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

23 Neni 4 i Udhëzimit Administrativ Nr. 18/2010 për përmbajtjen e kontratës për banesën me qira joprofitabile, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

24 Po aty neni 7 paragrafi 1 dhe 2

25 Neni 8 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2014 për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve për Sigurimin e banimit familjar për familjet e dëshmorëve, të zhdukurve të UÇK-së, për veteranët e UÇK-së, invalidët e luftës, viktimat e dhunës seksuale të luftës, viktimat civile të luftës dhe familjarëve të tyre, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10195>

Kuvendi Komunal, çdo vit para aprovimit të shumës së subvencionimit të qirasë vjetore, duhet ta bëjë vlerësimin e gjendjes ekonomike të familjeve, me qëllim të vazhdimin apo ndërprerjes së kontratës²⁶. Qiradhënësi (komuna) mund ta shkëpus kontratën nëse qiramarrësi apo shfrytëzuesit e tjerë të banesës shfrytëzojnë banesën në kundërshtim me kontratën për dhënien me qira të banesës, qiramarrësi nuk e paguan qiranë në afatin e kontraktuar, qiramarrësi apo shfrytëzuesit e tjerë të banesës nuk e shfrytëzojnë banesën për banim por e shfrytëzojnë për destinime të tjera²⁷.

Komuna e Prizrenit nga viti në vit ka vazhduar në hartimin dhe planifikimin e buxhetit - **komuna për investime kapitale** në kategorinë e banimit social. Ndarjet buxhetore të DPMS-së për vitin 2018 orientohen në këto politika: 300.000 Euro për investime kapitale në strehimin e qytetarëve, 400.000 Euro për ndërtimin e banesave për kategoritë e luftës dhe rasteve sociale, 350.000 euro për ndërtimin dhe funksionalizimin e shtëpisë së pleqve²⁸. Sa i përket investimeve kapitale, komuna e Rahovecit në vitin 2018 nuk ka paraparë asnjë projekt kapital në sferën e politikave sociale²⁹. Poashtu, edhe komuna e Dragashit nuk ka paraparë asnjë linjë buxhetore për investime kapitale³⁰.

Komuna e Prizrenit më 23 Maj 2013 kishte marrë vendim për themelimin dhe emërimin e Komisionit për ndarjen e banesave të ndërtuara në lagjen "Dardania" të dedikuara për familjet e dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe familjeve të rasteve sociale të komunës së Prizrenit³¹. Komisioni me datë 02.07.2013 kishte marrë vendim për shpalljen e konkursit për dhënien në shfrytëzim të 92 banesave, banesave për familjet e dëshmoreve, invalidëve të luftës së UÇK-së dhe familjeve me gjendje të rëndë sociale³².

26 Neni 12 i Udhëzimit Administrativ Nr. 18/2010 për përmbajtjen e kontratës për banesën me qira joprofitabile, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

27 Neni 13 i Udhëzimit Administrativ Nr. 18/2010 për përmbajtjen e kontratës për banesën me qira joprofitabile, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

28 Intervistë me Drejtorin e DPMS z. Fejzë Kabashi – Komuna e Prizrenit

29 Po aty tabela faqe 51

30 Tabela 4.1 e Ligjit Nr. 06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

31 Vendimi i Komunës së Prizrenit, <https://kk-arkiva.rks-gov.net/prizren/getattachment/7551e5a2-ddd0-4058-b316-f38aa2aa05b1/Vendimet-e-dates-23-05-2013.aspx>

32 Vendimi i datës 02.07.2013, Komuna e Prizrenit



REKOMANDIMET

- Ndryshimi i rregulloreve komunale për ndarjen e subvencioneve (Komuna e Prizrenit dhe e Dragashit);
- Implementimi dhe respektimi i rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve nga komuna e Rahovecit;
- Përfshirja e komunitetit dhe Organizatava të Shoqërisë Civile në hartimin e planit vjetor të shërbimeve sociale;
- Rritja e transparencës dhe publikimi i planit vjetor në ëeb faqen zyrtare të Komunës;
- Hartimi i planeve strategjike në nivel lokal për adresimin e nevojave sociale dhe familjare në periudha afatgjata;
- Rritja e buxhetit komunal për investime kapitale për politikën sociale të banimit në nivel lokal (komuna e Dragashit dhe Rahovecit);
- Vendosja e standardeve dhe respektimi i kriterëve në politikën e programeve të banimit social nga Komuna e Prizrenit;
- Krijimi i një Komisioni shumë palësh në monitorimin e zbatimit të kontratave me shfrytëzuesit aktualë të banesave sociale (Komuna e Prizrenit);
- Rritja e mbikqyrjes dhe bashkëpunimit ndërmjet MPMS dhe Komunave në hartimin e planeve strategjike për banimet sociale dhe ndarjen e banimeve sociale nga komuna;
- Hartimin e manualeve si politika të brendshme në rritjen e standardeve dhe përcaktimin në detaje të kriterëve për qasje në subvencione.
- Rritja e bashkëpunimit me komunitetin e donatoreve



LISTA E BURIMEVE TË SHFRYTËZUARA

Shtojca 10 e Rregullores Nr.02/2011 për fushat dhe përgjegjësit administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10533>

Ligji Nr.02/L-17 për shërbimet sociale dhe familjare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2447>

Ligji Nr.03/L-040 për vetëqeverisje Lokale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Ligji Nr. 04/L-069 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, [http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Primar/Ligji%20per%20N.P.%20e%20Ligjit%20per%20skemen%20sociale%20\(shqip\).pdf](http://mpms.rks-gov.net/Portals/0/Ligji/Primar/Ligji%20per%20N.P.%20e%20Ligjit%20per%20skemen%20sociale%20(shqip).pdf)

Ligji Nr.06/L-020 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

Ligji Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

Udhëzimi Administrativ Nr. 21/2010 për përcaktimin e radhës së përparësis për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

Udhëzimi Administrativ Nr.22/2010 për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

Udhëzimit Administrativ Nr.18/2010 për përmbajtjen e kontratës për banesën me qira joprofitabile, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2670>

Statuti të Komunës së Rahovecit, <https://kk.rks-gov.net/rahovec/ep-content/uploads/sites/23/2017/10/Statuti-i-Komunës-së-Rahovecit.pdf>

Rregullorja për ndarjen e subvencioneve – Komuna e Prizrenit, <https://kk.rks-gov.net/prizren/ep-content/uploads/sites/26/2018/01/rregullore-subvencion-26-prill.pdf>

Ëeb faqja e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, <http://mpms.rks-gov.net/sq-al/departament/departamentip%C3%ABrpolitikasociale dhe familjes/fush%C3%ABveprimtaria.aspx>

Publikimi i njoftimit për thirrje, <https://kk-arkiva.rks-gov.net/rahovec/getattachment/f3dd47a8-269a-4362-b335-8620a4c98142/Thirrje-per-aplikim.pdf.aspx>





INTERVISTAT:

Fejzë Kabashi – Drejtor i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale – Komuna e Prizrenit.

Samir Mustafa - Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale – Komuna e Rahovecit.

Behar Brenoli – Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – Komuna e Dragashit.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

364(496.51-2)(048)
304(496.51-2)(048)
Politikat sociale në nivel lokal : komuna e Prizrenit, komuna e Rahovecit, komuna e Dragashit : Qershor 2018 : analizë hulumtuese / përgaditur nga: Naim Cahanaj. - Prishtinë : Instituti Demokratik i Kosovës, 2018. – 28 f. ; 21 cm.
1.Cahanaj, Naim
ISBN 978-9951--745-17-8





"KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

THIRR

0800 77 777

**RAPORTO
KORRUPSIONIN**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jodomosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit

Me përkrahjen financiare të:

